

## STATUTI

### I

#### SHOQATËS "MARATON ALBANIA"

Sot në Tiranë, më datë 26. 04.2019, në bazë të ligjit nr.8789,datë 05.03.2014, ligji nr.8788 date7.05.2001,Nr.8781, datë 3.5.2001, me iniciativën e grupit nismëtar:

1,DASHAMIR ÇALI, i biri i Beqirit, lindur më 01.08.1958 në Tiranë, banues në Tiranë, adresa: Rr,. Vllazen Huta, pall. 101/9, me letërnjoftimi nr.F80801162O,

2. Leonard PEÇO, i biri i Janit, lindur me 29.04.1979 ne Tiranë, banues ne Tiranë, Blv. Gjergj fishta,. Pall. Agimi, shk.1,ap1, me letërnjoftimi nr. H40924103E.

3. Adrian BREGU, i biri i Pilo, lindur më 03.05.1962 ne Vlore, banues ne Tirane, Blv. Bajram Curri, Pall. 32,shk.4, me leternjoftimi nr.G20503205V.

4. Genc VEIS, i biri i Bajazitit, lindur më 21.04.1973 ne Tirane, banues ne Tiranë, adresa: Blv.Gjergj Fishta, pall. Agimi, shk.2,k.2, identifikuar me letërnjoftimi rn. H30421038P.

5. Besjana ZJARRI, e bija e Dragushit, lindur me 02.02.1991 ne Librazhd, banuese ne Tiranë, adresa: Rr.Dibres,nr.308/3, me letërnjoftimi nr.J15202054,

është themeluar Shoqata jofitimpruese " MARATON ALBANIA ".

#### NENI 1

Shoqata "MARATON ALBANIA", është një shoqatë sportive, jo qeveritare, jofitimpruese, e pavarur nga politika që ushtron veprimtarinë e saj në Tiranë dhe në gjithë Shqipërinë.

Shoqata bashkon njërëz të thjeshtë, sportistë, persona fizikë, juridike, specialistë, intelektualë të specialiteteve që janë të domosdoshëm për aktivitetin e saj.

#### NENI 2


Shoqata eshte person juridik qe vepron sipas ligjit shqiptar dhe do te njihet si e tillë ne castin e regjistrimit në Gjykatën e rrethit gjyqesor Tiranë.

#### NENI 3

#### SELIA E SHOQATËS

Shoqata e ka selinë në Tiranë, Rr. Vllazën Huta , Pallati 101, Shkalla 1, Ap.9 .

Veprimtaria e saj do te shtrihet ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperië duke hapur degë filiale në te gjithë vendin dhe jashte tij.



NENI 4

#### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISE TE SHOQATËS

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqatës do të jetë e papërcaktuar.

NENI 5

#### ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese dhe ekzekutive të shoqatës janë:

Mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të shoqatës.

Këshilli drejtues

Kryetari

NENI 6

#### Objekti i veprimtarisë së shoqatës është :

Objekti i shoqatës janë, bashkimi vullnetar i njerëzve të thjeshtë, sportistë, persona fizikë, juridikë, intelektualë, specialistë të fushës të sportit që janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqatës për zhvillimin e vrapimit me ecje, ecje sportive, vrapim aerobik, gjysëm maratone, maraton e plote, ultra maratonë, trialton, vrapim shpejtësie, i garave sportive, ediventimin e vlerave sportive në rrethet e Shqipërisë.


Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e të gjithë kategorive të ndryshme të njerëzve për t'u ushtruar sistematikisht në mënyrë të ndërgjegjshme me ecje, me vrapim aerobik, si një ndër aktivitetet fizike me efektshmëri të lartë e të gjithanshme jetësore, me vlera zhvilluese, profilaktike, dhe kurimi shëndetësor me qëllim të përmirësimit për një jetë sa më aktive dhe rendiment me të lartë mendor ,fizik shëndetësor, profesional.

Të ideoje, të krijojë, të drejtojë , të ndërgjegjësojë e të aktivizojë në këto lëvizje sportive masive një numër sa më të madh njerezish pavarësisht nga mosha, gjinia, shkalla e zhvillimit fizik,mendor, sportiv dhe shëndetësor.

Të ideoje, të informojë ndërmjet mediave , të sqarojë dhe inkurajojë njerezit për një domosdoshmëri në ndryshimin e mënyrës së jetesës , për një jetë sa më aktive e me rendiment të lartë, për një ekuilibër të plotë psikologjik, fiziologjik dhe shëndetësor.

të ideojë, të sigurojë bashkëpunimin dhe ndihmë nga institucionet e sportit, për të promovuar lëvizjen masive sportive për të gjithë shtresat e shoqërisë.

të ideoje, të zhvillojë leksione, panairë, aktivitete, simpoziume, biseda dhe konsulta me të gjithë të interesuarit për dobime të aktivitetit fizik.



të siguroje nje qender metodiko stervitore, fshat apo qytet stervitor maratone, maraton pista tekniko profesionale etj. per te krijuar kushte sa me optimale stervitore per ushtrimin amator sikurse ne ambientet e parkut te Liqenit Artificial te Tiranes, Parkun kombetar te "Dajtit" apo pisten per gjate rruges dhe shetitoren Pogradec – Fshati Lin – Fshati Tushemisht dhe te organizoje maratona te pervitshme per qytetin e Tiranes dhe ne rrethet e tjera te vendit, bazuar ne standartat kombetare dhe nderkombetare te Atletikes.

të zhvilloje konsulence teknike profesionale per permiresimin e stervitjes individuale te anetareve dhe te ineresuarve per vrapimin maratone.

të organizoje, te drejtoje e zhvilloje aktivitete masive sportive, ne nivel vendor, kombetar dhe nderkombetar per ecjen dhe vrapimin.

Shoqata do te promovojë interesat e anetareve te vet ne Shqiperi dhe jashte saj .

Shoqata do te botoje reviste periodike dhe materiale prapagandistike me interes.

Fushata ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi.

Lobing me aktorë të ndryshëm në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë.

Leksione, Seminare dhe konferenca kombëtare dhe rajonale.

Aktivitete në praktikë në mbështetje të aktiviteteve sportive.

Aktivitete të reklamimit të veprimtarisë në përputhje me qëllimet e shoqates.

Trajnime dhe shoqerime të ndryshme te grupeve te interesit dhe personave me aftesi te kufizuar.

Përpunime materialesh në fushën e sportit te maratones.

Bashkëpunime me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë Shqipërisë me qëllime të përbashkëta sportive.

Aktivitete promovuese të aktorëve të ndryshëm për identifikimin e çështjeve kryesore në qëllim të promovimit te vlerave sportive te vrapimit maraton.


Prodhime, publikime, dokumentarë, reportazhe duke ruajtur te drejtën e autorit mbi programe audiovizuale dhe të shtypit të shkruar në mbështetje te vlerave sportive te vrapimit.

Botime periodike të ndryshme që janë të lidhura ngushtë në mbështetje te vlerave sportive te vrapimit.

Per realizimin e programit te saj shoqata do te kerkoje ndihme e bashkepunim jo vetem brenda vendit por edhe nga individe dhe shoqata te tjera homologe jashte vendit.

NENI 7

**Qellimi dhe fusha e veprimtarise te shoqates**



Qellimi i shoqates eshte:

Bashkepunimi dhe organizimi i aktiviteteve sportive, me shoqata te tjera brenda dhe jashte vendit.

Mban lidhje te vazhdueshme me organet e pushtetit vendor, institucionet perkatese dhe ne bashkeveprim me to kujdeset dhe organizon:

Kualifikimin e anetareve te shoqates, me ane te seminareve,eksperiencave te huaja, konsultave e sesioneve tekniko – shkencore, aktiviteteve sportive ne Tirane apo ne rrethet e Shqiperise.

Mban lidhje me shoqata te tjera homologe brenda dhe jashte vendit, vendos kontakte me to, duke kerkuar ndihma dhe donacione humane dhe duke i pasqyruar ato sipas ligjeve ne fuqi. I fton ato per te marre pjese ose merr pjese ne aktivitete respektive ose organizon aktiviteve te perbashketa te karakterit sportiv.

Nxitja , te organizoje dhe te mbeshtese realizimin e veprimtarive sportive ne nivel lokal dhe kombetar.

Trajnime, workshope, leksione, seminare mbi menaxhimin e projekteve te zhvillimit te sportit botime librash,revistave, etj.

Propagandon qellimet kryesore te saj dhe perpiqet per te terhequr nje numer sa me te madh anetaresh te interesuar per aktivitetin e shoqates.

NENI 8

Shoqata ka vulen dhe emblemen e saj, te cilat do te shoqerojne te gjithe dokumentacionin dhe publikimet e saj, ne te cilat do te vendosen inicialet; emblema, emri i shoqates dhe simboli i saj. Per dekumentacionin teknik qe shoqerohet me vulen perkatese domosdo duhet emri dhe nenshkrimi i Kryetarit te shoqates.

NENI 9

Shoqata e ka te ndaluar shperndarjen e fitimeve midis anetareve te saj.


Shoqata e ka te ndaluar mbledhjen e te ardhurave dhe cdo lloj pagese nga te trete nga pjesetaret e saj ne emer dhe pa dijenine e kryesise se shoqates.

NENI 10

KOMPETENCAT E ORGANEVE DREJTUESE

Mbledhja e Pergjithshme e anetareve eshte organi me i larte i vendimeve ne te cilen amrrin pjese te gjithe anetaret e saj.

Mbledhja e Pergjithshme e anetareve thirret nga keshilli drejtues i shoqates ose me kerkese nga 1/5 e anetareve te shoqates.





Mbledhja e anetareve mbahet ne cdo vit, ne kohen dhe ne vendin e caktuar nga mbledhja e Pergjithshume ose nga 1/5 e anetareve qe kerkojne thirrjen e saj.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve, me votim te fshehte.

#### NENI 11

#### KOMPETENCAT E MBLEDHJES SE PERGJITHSHME TE SHOQATES

Mbledhja e pergjithshme e anetareve vendos:

Per ndryshimin e statutit, rregullave te brendshme.

Percakton fushat dhe programet e veprimtarise se shoqates.

Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre, drejtimin e punes se shoqates.

Zgjedh ne cdo tre vjet keshillin drejtues te saj, kryetarin si dhe perfaqesuesit sipas rastit.

Miraton raportin vjetor te punes se shoqates.

Shqyrton dhe miraton veprimtarine e kryetarit, miraton buxhetin dhe shpenzimet per vitin e ardhshem.

Mbledhja e pergjithshme e anetareve merr vendime me votim te fshehte.

Vendimet quhen te vlefshme nqs per to ka votuar me shume se gjysma e anetareve te pranishem.

Mbledhja e pergjithshme vendos per bashkimin ose ndarjen e shoqates.

Mbledhja e pergjithshme vendos me shumice te thjeshte votash te te gjitha anetareve per ndryshimet ne statut dhe per sheprndarjen e shoqates.

Mbledhja merr vendime te vlefshme kur ne te marrin pjese me shume se 1/2 e anetareve te shoqates.

#### NENI 12

#### KESHILLI DREJTUES

#### KOMPETENCAT E KESHILLIT DREJTUES

Keshilli drejtues i shoqates zgjidhet ne cdo tre vjet me votim te fshehte nga mbledhja e pergjithshme.

Keshilli drejtues i shoqates zgjedh kryetarin e keshillit drejtues, zv/kryetarin, sekretarin dhe nje pergjegjes per financen.

Mbledhjet e keshillit jane te rregullta kur jane ftuar te gjitha anetaret dhe marrin pjese ne te 1/2 e tyre.

Vendimet merren me shumicen e thjeshte te votave te pranishme ne mbledhje. Ne rast se votat jane te barabarta, vota e kryetarit te shoqates konsiderohet vendimtare ne marrjen e vendimeve.

#### KESHILLI DREJTUES KA KETO KOMPETENCA:

Pergatit projekt- programe vjetor te aktiviteteve dhe ia paraqit per miratim Mbledhjes te Pergjithshme.

Aprovon raportin vjetor te realizimit te detyrave te shoqates.

Cakton menyren e realizimit te te ardhurave te shoqates.

Vendos per ndryshimet qe duhen bere ne rregullimet e shoqates.

Merr ne shqyrtim dhe vendos per propozimet qe behen nga organe dhe organizata te ndryshme me qellim bashkepunimi e ndihme te ndersjellte.

Punesimin e personave ne shoqate ne baze te legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### NENI 13

Kryetari ka keto kompetenca:

Drejton veprimtarine e shoqates ne baze te statutit.

Administron fondet sipas menyres se caktuar nga keshilli drejtues.

Hyn ne marredhenie me shoqata te tjera dhe perfaqeson shoqaten ligjerisht ne marredhenie me te tretet.

Ka te drejten e hapjes te numrit te llogarise ne emer te shoqates dhe ka te drejten e firmes ne Banke.

Kujdeset per interesat e shoqates, i mbron ato.

#### NENI 14

##### ANETARESIMI

Anetar i shoqates mund te jete cdo qytetar pa dallim bindjesh, besimi apo kombesie, mjafton te pranoje programin dhe statutin.

Te kete mbushur moshen 18 vjec.

Miratimi i kerkeses per anetaresim ne shoqate behet nga Mbledhja e Pergjithshe.

Ne kerkesen per anetaresim ne shoqate percaktohet data e anetaresise, kuota si dhe nje deklarate ku kerkuesi bie dakort te veproje ne perputhje me ligjin, statutin dhe rregullat e tjera te shoqates. Anetari i ri, rregjistrohet ne librin e shoqates.



Anetaresimi ne shoqate konsiderohet i kryer vetem pas miratimit dhe pageses se kontributit perkates.

Kuota fillestare e regjistrimit do te jete 2000 leke, (paisja me karte anetaresimi) ndersa kuota vjetore do te jete 1000 Leke ( njemije ). Keto kuota jane te ndryshueshme me vendimin e kryesise se shoqates.

NENI 15

#### VOTIMI DHE PERFAQESIMI

Cdo anetar i shoqates ka te drejten e nje vote te barabarte per ceshtjet e shtruara per votim ne Mbledhjen e Pergjithshme te anetareve.

E drejta e anetaresise ne shoqate nuk mund te tjetersohet dhe as nuk mund te kalohet me rruge trashegimie.

NENI 16

#### DOREHEQJA

E drejta per te dhene doreheqjen eshte e garantuar, por me kusht qe te jete paraqitur me shkrim tre muaj para ne nje nga organet drejtuese te shoqates.

Anetaret qe kane dhene doreheqjen ose qe jane te perjashtuar nga shoqata nuk kane te drejta mbi kapitalin e shoqates.

Anetari i shoqates qe jep doreheqjen, nuk shkarkohet nga detyrimet e tij ndaj shoqates ne lidhje me demet e shkaktuar shoqates per faj te tij dhe me pagesen e kontributeve , te cilat jane te pagueshme ne kohen e paraqitjes se doreheqjes.


NENI 17

#### PERFUNDIMI I ANETARESISE

Anetari i shoqates qe nuk paguan plotesht kontributin vjetor brenda tre muajve te vitit pasardhes, mund te perjashtohet nga shoqata, pervec sa me siper edhe per shkaqe te tjera te arsyeshme me vendim te mbledhjes te pergjithshume me shumice votash kur te pranishem jane  $\frac{3}{4}$  e anetareve te shoqates.

Nje anetar largohet nga shoqata, pervec sa me siper edhe per shkaqe te tjera te arsyeshme, te cilat duhet te paraqiten me shkrim te pakten 20 dite para, me qellim qe t'i krijohet mundesia per t'u shprehur para Mbledhjes te pergjithshme, ne lidhje me shkaqet qe kane sjelle propozimin per perjashtimin e tij.

Shkaqe te arsyeshme mbi bazen e te cilave mund te kerkohet prjashtimi nga shoqata i anetarit te shoqates ( por qe nuk jane te vetmet),konsiderohen sa me poshte vijon:



.Shkelje te dispozitave te statutit ose rregullave te tjera te shoqates.

.Mospagimi i detyrimeve qe shkaktojne pergjegjesine e shoqates.

.Kryerja e veprimeve qe bien ne kundërshtim te hapur me normat etike te shoqates.

.Kryerja e veprimeve qe demtojne interesat e shoqates.

#### NENI 18

#### BURIMET E FINANCIMIT

Shoqata hap llogarine e vete prane bankave Shqiptare

Burimet financiare te shoqates jane :

Kuotat e anetareve ( vjetore ).

Çdo anetar i shoqates do te paguaje kuatizacionin e tij cdo 12 mujor ne shumen 1000 Leke ( njemije leke)

Ndihma nga donatore dhe sponsore te ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas ose te huaj,nga insitucionet e ndryshme shtetore qe jane te interesuar te mbeshtetin aktivitetin e shoqates.

Financime per realizimin e projekteve te vecanta nga strukturat shtetore si dhe nga Bashkite, Komunat.

Financime per realizimin e projekteve te vecanta te saj, nga individe dhe shoqata te ndryshme ne perputhje me objektin dhe qellimin e saj dhe ne perputhje me legjislacionin e vendit per donatoret dhe sponsorat.

Te ardhurat financiare nga veprimtaria ekonomike e shoqates ne perputhje me legjislacionin sipas miratimit te mbledhjes te pergjithshme te anetareve.


Te ardhurat nga reklamat e ndryshme te veprimtarise se shoqates.

Marketingut te aktiviteve turistike dhe agrokultures.

#### NENI 19

Shoqata ka te drejte te kete ne pronesi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, te realizoje te ardhura nepermjet administrimit te ketyre pasurive, si dhe ushtrimit te veprimtarive te tjera, ne perputhje me ligjin dhe me qellimin e objektin e veprimtarise se shoqates, te parashikuar ne statutin e saj.

Te ardhurat e realizuara nga shoqata duhet te perdoren vetem per realizimin e veprimtarive qe parashikohen ne qellimin dhe objektin e veprimtarise se parashikuar ne statutin e saj.





Nuk lejohet qe shoqata te kryeje veprimtari fitimprurese.

NENI 20

### SHPERNDARJA E SHOQATES

Shperndarja e vullnetshme e shoqates vendoset vetem ne mbledhjen e organizuar per kete qellim nga asambleja e pergjithshme dhe vetem me 2/3 e votave te pjese-marresve.

Shperndarja e shoqates behet:

- a) me vendim te mbledhjes se pergjithshme te anetareve te saj.
- b) kur numri i anetareve eshte nen numrin minimal te caktuar.
- c) kur qellimi i shoqates eshte permbushur ose nuk mund te permbushet me.
- ç) kur vertetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari te kunderligjshme.
- d) ne raste te tjera te parashikuara nga ligji.

NENI 21

Kur vendoset shperndarja e shoqates , shoqata vihet ne likuidim sipas ligjit ne fuqi.

Likujdatori ben vleresimin e gjendjes financiare te shoqates dhe pasurine e saj ne momentin e vendimit per shperndarjen e saj dhe evidencon te gjithe kreditorët dhe debitorët e mundshem.

Pas pagimit te detyrimeve qe shoqata mund t'u kete te treteve, likujdatori ben vleresimin e pasurise se mbetur dhe kujdeset qe kjo pasuri te shkoje sipas destinacionit te percaktuar nga Mbledhja e Pergjithshme.

NENI 22


### ADMINSITRIMI

Keshilli drejtues percakton nje vit fiskal per shoqaten, ndalon shperndarjen e fitimeve midis anetareve te shoqates, vëzhgon administrimin korekt te aktiveve dhe pasiveve te shoqates dhe siguron qe praktikat e standarteve te kontributit, jane ndjekur nga ata qe aktualisht merren me perdorimin e fondeve, pagimin e faturave, te te hollave dhe te shpenzimeve per aktivitetet e shoqates.

NENI 23

Shoqata ushtron aktivitetin dhe veprimtarine e saj ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar, ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

Ajo nuk pranon dhurata apo sponsorizime nga persona fizike ose juridike qe shkelin te drejtat dhe lirite e njeriut , vendimet dhe ligjet e shtetit Shqiptar.




NENI 24

Per cfare nuk parashikohet ne kete statut, referimi do te behet ne dispozitat ligjore ne fuqi ne Republikën e Shqiperise dhe kryesisht ne ato te ligjit nr. 8788 date 07.05.2001 per “ organizatat jofitimprurese” dhe ato te Kodit Civil.


Statuti nenskruhet me vullnetin e lire nga anetaret themelues.

ANETARET THEMELUES TE SHOQATES


DASHAMIR ÇALI




LEONARD PEÇO




ADRIAN BREGU



GENC VEIS

Genc Veis  


BESJANA ZJARRI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA KOMBETARE TE NOTERISE  
DEGA VENDORE TIRANE

NR. REP 862  
Nr. kol. 241

VERTETIM

Ne Tirane, sot ne daten 26.04.2019 para meje noteres Fatmara N. Shehu, me seli me Blv. Gjergj Fishta, Nd.34,h.6,nj.7,u paraqit personalisht:

KERKUESI

1,DASHAMIR ÇALI, i biri i Beqirit, lindur me 01.08.1958 ne Tirane, banues ne Tirane, adresa: Rr,. Vllazen Huta, pall. 101/9, me leternjoftimi nr.F80801162O,

2. Leonard PEÇO, i biri i Janit, lindur me 29.04.1979 ne Tirane, banues ne Tirane, Blv. Gjergj fishta,. Pall. Agimi, shk.1,ap1, me leternjoftimi nr. H40924103E.

3. Adrian BREGU, i biri i Pilo, lindur me 03.05.1962 ne Vlore, banues ne Tirane, Blv. Bajram Curri, Pall. 32,shk.4, me leternjoftimi nr.G20503205V.

4. Genc VEIS, i biri i Bajazitit, lindur me 21.04.1973 ne Tirane, banues ne Tirane, adresa: Blv.Gjergj Fishta, pall. Agimi, shk.2,k.2, identifikuar me leternjoftimi rn. H30421038P.

5. Besjana ZJARRI, e bija e Dragushit, lindur me 02.02.1991 ne Librazhd, banuese ne Tirane, adresa: RR. Dibres,nr.308/3, me leternjoftimi nr.J15202054L

madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me vullnet te lire e te plote deklarojne se sa siper nenshkruan statutin e shoqates 'MARATON ALBANIA'.

Une noterja pasi gjeta permbajtjen e aktit sipas ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre.

Sipas nenit 62 te ligjit " Per Noterine" NR. 110/2018, date 20.12.2018

NOTERE

FATMARA SHEHU

